

**THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT PËR ANGAZHIM PËR DY
ESKPERT LIGJOR:**

Informatat e përgjithshme			
Përshkrimi i punës/shërbimit	Ekspert (konsulentë) ligjorë për përshtatjen e materialit dhe mbajtjen e trajnimeve për të drejtat ligjore të tokës dhe pronës për komuniteti e të verbërve dhe te shurdhërve		
Titulli I Projektit/Programit	PIAKOS		
Pozita	Ekspert Ligjor		
Niveli I konsulentit:	Senior/Ekspert		
Lokacioni:	Prishtinë, Kosovë		
Kohëzgjatja e angazhimit:	18 dite ne total, 9 dite secili ekspert		
Data e kërkesës:	24.07.2024	Afati I fundit për aplikim	9.08.2024
Data e planifikuar e fillimit:	19.08.2024		
Autoriteti kontraktues:	ShVK		

1. Hyrje

SHVK është vazhdimësi e lidhjes së të verbërve të Kosovës e themeluar në vitin 1947 dhe e riorganizuar në vitin 2003.

SHVK është organizatë jo qeveritare, jo profitabile e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike, e cila angazhohet për mbrojtjen, përfaqësimin dhe afirmimin e interesave dhe të drejtave të qytetarëve të verbër, pa dallim moshe, gjinie, përkatësie etnike dhe fetare.

SHVK, angazhohet në vazhdimësi për zbatueshmërinë e plotë të legjislacionit kosovar lidhur më personat me aftësi të kufizuar, e në veçanti për Ligjit për personat e verbër (04/L-092), dhe ligjeve të tjera ekzistuese që rregullojnë dhe mbrojnë të drejtat e personave të verbër.

Si rrethojë, integrimi i personave të verbër në jetën publike dhe aftësimi i tyre për jetë të pavarur është një nga sfidat më të mëdha dhe synimi kryesor i SHVK.

Politikat zhvillimore të SHVK fokusohen edhe në faktorizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personat e verbër, dhe vetëdijesim e qytetarëve për përkrahje ndaj tyre. Këto politika implementohen përmes fushatave avokuese, debateve publike, konferencave, publikimeve të ndryshme

Vizioni

Personat e verbër, qytetarë të barabartë, të pavarur dhe kontribuues në shoqëri.

Misioni

Ne përfaqësojmë personat e verbër dhe me dëmtim në të parë duke kontribuar në socializim, edukim, punësim dhe rehabilitim dhe duke u angazhuar dhe besuar në gjithëpërfshirje dhe pavarësim të tyre.

2. Rreth projektit dhe qëllimi i angazhimit

Projekti Nisma për të Drejtën e Pronës (NDP), zbatohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), bashkë-zbatohet nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe financohet nga Banka Botërore/ Fondi për Paqe dhe Shtet-Ndërtim. NDP, synon të adresojë nevojën kritike për përmirësimin e qasjes në informacionin për regjistrimin e tokës dhe pronës, si dhe ofrimin e shërbimeve të këshillimit në lidhje me të drejtat pronësore për gratë, të rinjtë dhe personat e cenueshëm në Kosovë. Aktivitetet e projektit do të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqësor, duke ndihmuar komunitetet me dokumentacionin e nevojshëm dhe të mbështetur ligjërisht për forcimin e sigurisë së të drejtave mbi tokën/pronën, duke ofruar një mundësi për pjesëmarrjen e tyre në ekonominë më të gjerë dhe duke vendosur bazat për një shoqëri më të barabartë

Shoqata e të Verbërve të Kosovës si bashkë-zbatuese e projektit NDP, në kuadër të këtij projekti do të angazhojë 2 ekspert ligjor.

3. Detyrat e punës

Ekspertët (konsulentët) duhet të draftojë apo hartojë materialet e trajnimit për të drejtat pronësore dhe rrugët ligjore për realizimin e kësaj të drejte për personat e verbër mbi rëndësinë e regjistrimit të pronave dhe të mirat që i sjellë regjistrimi.

Ekspertët (konsulentët) duhet të draftojë apo hartojë materialet e trajnimit për të drejtat pronësore dhe rrugët ligjore për realizimin e kësaj të drejte për personat e shurdhër mbi rëndësinë e regjistrimit të pronave dhe të mirat që i sjellë regjistrimi.

Ekspertët (konsulentët) duhet të realizoj prezanton materialet në të gjitha punëtorit duke ofruar njohuri rreth të drejtave të pronës për përfituesi nga komuniteti i të verbërve dhe të shurdhërve.

Ekspertët (konsulentët) ka të drejtë të propozojë informatat të tjera për material trajnues për të cilën mendon se duhet të jenë pjesë e këtij materiali.

Ekspertët (konsulentët) duhet të përgatisë materialin në bashkëpunim me menaxhmentin e SHVK dhe SHKSH si dhe Menaxherët e PIAKOS, dhe ta dërgojë paraprakisht tek SHVK dhe ATRC për aprovim para se të finalizohet. Ekspertët (konsulentët) duhet të sigurohet që materiali i përdorur dhe i prodhuar nuk ka konflikt me kornizën ligjore dhe të drejtat e njeriut.

Eksperti duhet të mbajë përgjegjësi mbi përmbajtjen e materialit.

4. Rezultatet e Pritura

No.	Outputi	Kohëzgjatja	Kërkohej Rishikim dhe Aprovim
1	Drafti i parë i materialit mbi të drejtat pronësore për grupet e cënueshme në Kosovë	Më së largu deri më 2 shtator 2024	PO (nga SHVK,SHKSH dhe ATRC)
2	Materiali përfundimtar (nëse ka kërkesë nga SHVK, SHKSH dhe ATRC për ndonjë ndryshim eventual)	Me së largu deri më 5 shtator 2024	PO (nga SHVK,SHKSH dhe ATRC)
3	Përgatitja edhe adresimi i komenteve të dalura nga praktika e përdorimit të manualit.	Më së largu deri më 5 shtator 2024	PO (nga SHVK,SHKSH dhe ATRC)
4	Realizimi i trajnimeve	06 shtator-31 tetor 2024	PO (nga SHVK,SHKSH dhe ATRC)
5	Përgatitja e raportit final	10 nëntor 2024	PO (nga SHVK,SHKSH dhe ATRC)

5. Kohëzgjatja

- 9 ditë punë për secilin ekspert, nga periudha gusht deri në tetor 2024
- Data e paraparë e fillimit të angazhimit 19.08.2024

6. Përvoja dhe Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë e avancuar në drejtësi, e preferueshme në të drejtën civile ose të drejtën pronësore.
- Të kenë përvojë minimale prej 8 vitesh në fushën ligjore, e preferueshme në fushë civile.
- Përvojë e dëshmuar në draftim ose hartim të manualeve në gjuhë miqësore për targetin e specifikuar më lartë.
- Njohje e dëshmuar e praktikave dhe procedurave të aplikueshme në institucionet e Kosovës, të cilat trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronës.
- Përvojë e dëshmuar në analizimin dhe interpretimin e kuadrit ligjor, veçanërisht në kontekstin e pronës, trashëgimisë, procedurës civile, etj.

7. Procedura dhe kriteret për përzgjedhjen për këtë kontraktim

Nr.	Kapaciteti Teknik	Pikët
1	Dëshmi të eksperiencës së paku 8 vjeçare në fushën e kërkuar	40
2	Metodologjia dhe plani i punës	40
3	2 Reference	20
Total pikët		100

Vetëm kandidatet e përzgjedhur për liste të ngushte do të ftohen për interviste.

8. Procedurat e Aplikimit

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë përmes E-mail-ve: info@shvkosova.com, ose shv.kosova@gmail.com, ose fizike në adresën; “Bregu i Diellit”, I lam V, Rr. Rifat Burgjeviç, zbl 6, 10000, Prishtinë Kosovë, me subjektin: Aplikim për pozitën Ekspert ligjor.

Dokumentet për te u përcjellur janë:

- CV-ja
- Letër motivimi
- Metodologjia dhe plani i punës
- 2 Referenca relevante

9. Pagesa

Pagesa dhe format e pagesës do të bëhet pas aprovimit final të anagazhimit.